



udhëzimet për përdorim  
használati útmutató

Lavatriçe  
Mosógép

EWP 86100 W  
EWP 106100 W  
EWP 126100 W

## Electrolux. Thinking of you.

Bëhuni edhe ju pjesë e botëkuptimit tonë në  
www.electrolux.com

## PËRMBAJTJA

Të dhëna për sigurinë	2	Përdorimi i parë	10
Masat paraprake kundër ngrirjes	4	Përdorimi I përditshëm	10
Probleme që lidhen me mjedisin	4	Programet e larjes	19
Përshkrim i produktit	5	Vlerat e konsumit	22
Të dhëna teknike	6	Kujdesi dhe pastrimi	22
Instalimi	6	Si të veprojmë nëse...	26

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.



## TË DHËNA PËR SIGURINË

**E rëndësishme** Lexojini udhëzimet me kujdes dhe ruajini ato për t'iu referuar në të ardhmen.

- Siguria e pajisjes suaj elektro-shtëpiake pajtohet me standardet e industrisë dhe me kërkesat ligjore mbi sigurinë e pajisjeve elektro-shtëpiake. Megjithatë, si prodhues, ne e ndjejmë si detyrën tonë që të ofrojmë shënimet e mëposhtme në lidhje me sigurinë.
- Është e rëndësishme që ky libër udhëzimesh të ruhet bashkë me pajisjen për referime të mëtejshme. Nëse pajisja shitet ose i transferohet një pronari tjetër ose nëse ndërroni shtëpi dhe e lini pajisjen atje, sigurohuni gjithmonë që libri të shoqërojë pajisjen, në mënyrë që pronari i ri të njihet me funksionimin e pajisjes dhe paralajmërimet e rëndësishme.
- Ju DUHET t'i lexoni ato me kujdes para se të instaloni ose vini në përdorim pajisjen.
- Para se ta ndizni për herë të parë, kontrolloni pajisjen për ndonjë dëmtim që shkaktohet gjatë transportit. Kurrë mos lidhni një pajisje të dëmtuar. Nëse pjesët janë dëmtuar, kontaktoni me furnizuesin tuaj.
- Nëse pajisja merret në muajt e dimrit kur ka temperatura nën zero. Mbajeni pajisjen në temperaturën e dhomës për 24 orë para se ta përdorni për herë të parë.
- Kjo pajisje është prodhuar për përdorim normal shtëpiak. Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëmtime për shkak të ngricës. Lexoni "Parandalim i formimit të brymës".

## Siguria e përgjithshme

- Është e rrezikshme të ndryshoni specifikimet apo të përpiqeni ta modifikoni këtë produkt në çdo mënyrë të mundshme.
- Gjatë programeve të larjes me temperatura të larta, xhami i derës mund të nxehet. Mos e preknit!
- Sigurohuni që kafshët e vogla shtëpiake dhe fëmijët të mos futen në kazan. Për ta shmangur këtë, ju lutemi kontrolloni brenda kazanit përpara se të përdorni pajisjen.
- Çdo objekt i tillë si monedha, paramane, gozhdë, vidha, guriçka ose çdo lloj tjetër materiali i mprehtë mund të shkaktojë dëmtime të mëdha, kështu që nuk duhet të vendoset brenda në pajisje.
- Përdorni vetëm sasitë e këshilluara të zbutësit të rrobave dhe detergjentit. Nëse përdorni sasi më të madhe se ç'duhet, mund të dëmtoni pajisjen. Referojuni udhëzimeve të prodhuesit lidhur me sasitë.
- Lajini teshat e vogla, të tilla si çorapet, lidhëset, rripat e mesit (që lahen) etj. të futura në një qeskë për larje apo në një këllëf jastëku, pasi të tilla tesha mund të rrëshqasin midis kazanit dhe çikrikut të brendshëm.
- Mos e përdorni pajisjen për të larë tesha të gomua, tesha pa bordurë të kthyer ose materiale të grisura apo të shqyera.
- Pas përdorimit, pastrimit dhe mirëmbajtjes, shkëputeni gjithmonë pajisjen nga rrjeti elektrik dhe mbyllni çelësin e furnizimit me ujë.

- Në asnjë mënyrë nuk duhet të përqipeni ta riparoni pajisjen vetë. Riparimet e kryera nga persona pa përvojë, do të shkaktojnë plagosje ose keqfunksionim serioz. Kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit. Këmbëngulni gjithmonë në përdorimin e pjesëve të këmbimit origjinale.

### Instalimi

- Kjo pajisje është e rëndë. Bëni kujdes kur e lëvizni atë.
- Përpara përdorimit hiqni çdo mjet paketues dhe bulonat e transportit. Nëse nuk bëni kështu, produkti dhe ambienti juaj do të dëmtohen rëndë. Shihni paragrafin përkatës në manualin e përdorimit.
- Kjo pajisje është prodhuar vetëm për të qëndruar e lirë në këmbë. **MOS** e vendosni atë nën një mobilie dhe **MOS** e hiqni pjesën e sipërme për asnjë arsye.
- Pasi të keni instaluar pajisjen, kontrolloni që të mos ketë shkelur zorrën e furnizimit me ujë dhe të kullimit, si dhe që plani i sipërm të mos ketë shtypur kabllin e ushqimit elektrik pas murit.
- Instalojeni pajisjen mbi një dysheme të fortë e të sheshtë.
- Mos vendosni kurrë karton, dru apo materiale të ngjashme nën pajisje për të kompensuar një dysheme jo të sheshtë.
- Nëse pajisja është vendosur mbi një dysheme të shtruar me tapet, ju lutemi të rregulloni këmbëzat në mënyrë të tillë që të lejoni ajrin të qarkullojë lirisht nën pajisje.
- Kontrolloni që pajisja të mos prekë murin apo njëri të tjera në kuzhinë.
- **Kjo pajisje duhet të lidhet me një furnizim me ujë të ftohtë.**
- Mos përdorni zorrën e pajisjes suaj të mëparshme për ta lidhur pajisjen me rubinetin e ujit. Përdorni gjithmonë zorrën e marrë bashkë me pajisjen.
- Zorra e hyrjes së ujit duhet të zgjatet. Nëse ajo është shumë e shkurtër dhe nuk dëshironi të lëvizni rubinetin, do t'ju duhet të blini një të re, më të gjatë dhe veçanërisht të projektuar për këtë përdorim.
- Sigurohuni gjithmonë që nuk ka rrjedhe uji nga zorrët si dhe për lidhjet e tyre pas instalimit.

- Nëse pajisja është instaluar në një vend të ftohtë, ju lutemi lexoni kapitullin "Parandalimi i formimit të brymës". Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime për shkak të ngricës.
- Çdo ndërhyrje hidraulike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një hidraulik i kualifikuar ose nga një person i aftë.
- Çdo ndërhyrje elektrike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një hidraulik i kualifikuar ose nga një person i aftë.

### Përdorimi


- Kjo pajisje është ndërtuar për përdorim shtëpiak. Ajo nuk duhet përdorur për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është projektuar.
- Lani vetëm tresa që janë të përshtatshme për t'u larë në lavatrice. Ndiqni udhëzimet në çdo etiketë mbi tresa.
- Mos e mbingarkoni pajisjen. Shihni "Tabela e programeve të larjes".
- Përpara larjes, sigurohuni që xhepat e teshave të jenë bosh si dhe kopsat dhe zinxhirët të jenë të mbërthyer. Shmangni larjen në pajisje të teshave të ngrëna apo të grisura si dhe trajtojini paraprakisht njollat nga boja e murit, boja e shkrimit, ndryshku e bari, përpara se t'i lani ato në pajisje. Reçipetat me tela NUK duhet të lahen në pajisje.
- Sirtari shpërndarës i detergjentit është i pajisur me një ndarje për detergjent të lëngshëm. Mos përdorni këtë ndarje për detergjente xhelatinozë, me programe që përfshijnë paralarjen, me opsionin e shtyrjes së programit. Në këto raste mund të përdorni sfera matjeje ose qese me të cilat jepet detergjenti. Hiqeni mjetin matës në fund të ciklit të larjes.
- Teshat që janë ndotur me nënprodukte shpërthyesë të naftës nuk duhet të lahen në pajisje. Nëse përdorni lëngje pastruese shpërthyesë, duhet të bëni kujdes që lëngu të mënjanohet nga tresa përpara se ta fusni në pajisje këtë të fundit.
- Mos e tërhiqni kurrë kabllon ushqyese për të hequr spinën nga priza; kapeni gjithmonë nga vetë spina.

- Mos e përdorni kurrë pajisjen tuaj të re nëse kabulli i ushqimit, paneli i kontrollit, sipërfaqja e punës apo bazamenti janë të dëmtuar në mënyrë të tillë që e bëjnë të arritshme brendësinë e tharëses.

### Siguria për fëmijët

- Kjo pajisje nuk është ndërtuar për t'u përdorur nga persona (përfshirë fëmijët) aftësitë fizike, ndjesore ose mendore të cilëve, ose mungesa e përvojës dhe njohurive i pengon ata të përdorin pajisjen me siguri pa mbikëqyrjen ose udhëzimet e një personi përgjegjës, për të siguruar që ata e përdorin pajisjen me siguri.
- Fëmijët duhet të mbikëqyren për t'u siguruar se nuk luajnë me pajisjen.
- Materialet e paketimit (si p.sh. fletët plastike, bukëpeshku) mund të jenë të rrezikshme për fëmijët – ka rrezik asfiksioni! Mbajini ato larg fëmijëve.
- Mbajini të gjithë detergjentet në një vend të sigurt e të paarrtshëm për fëmijët.
- Sigurohuni që fëmijët ose kafshët shtëpiake të mos futen brenda në kazan. Për të shmangur rrezikun e bllokimit brenda kazanit të fëmijëve ose kafshëve

shtëpiake, pajisja ka një mekanizëm të posaçëm. Për ta **aktivizuar** këtë funksion, rrotullojeni (pa e shtypur) në drejtim orar butonin brenda derës, derisa gjuhëza të jetë në pozicion horizontal. Nëse është e nevojshme përdorni një monedhë.



Për ta **çaktivizuar** këtë mekanizëm dhe për të mundësuar sërish mbylljen e derës, rrotulloni butonin në drejtim kundërorar derisa gjuhëza të jetë vertikalisht.


## MASAT PARAPRAKE KUNDËR NGRIRJES

Nëse pajisja instalohet në një vend ku temperatura mund të bjerë poshtë 0°C, vazhdoni si më poshtë për të larguar të gjithë ujin e mbetur brenda pajisjes:

1. shkëputeni pajisjen nga energjia;
2. mbyllni rubinetin e ujit;
3. zhvendosni zorrën e furnizimit me ujë nga rubineti;
4. shkëpusni zorrën e kullimit nga pjesa mbajtëse e pasme dhe hiqeni atë nga lavamani ose rubineti;

5. vendosni një tas mbi dysheme;
6. lëreni zorrën e kullimit të qëndrojë përgjatë dyshemesë, vendosni skajet e jashtme të zorrëve të kullimit dhe të hyrjes në tasin e vendosur në dysheme dhe lini që uji të zbrazet plotësisht;
7. vidhoseni zorrën e hyrjes së ujit sërish dhe rivendosni zorrën e kullimit;

Kur ta vini sërish në punë pajisjen, sigurohuni që temperatura e dhomës të jetë mbi 0°C.



## PROBLEME QË LIDHEN ME MJEDISIN

## Materialet ambalazhuese

Materialet e shënuara me simbolin ♻ janë të riciklueshme.

>PE<=polietilen

>PS<=polistiren

>PP<=polipropilen


Kjo do të thotë se ato mund të riciklohen duke i hedhur ato siç duhet të kazanët e posaçëm të grumbullimit.

## Këshilla ekologjike


Për të kursyer ujin, energjinë si dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e ambientit, ju këshillojmë të ndiqni këto këshilla:

- Teshat me ndotje normale mund të lahen pa paralarje, për të kursyer kështu detergjentin, ujin dhe kohën (edhe ambienti mbrohet gjithashtu!).
- Pajisja punon në mënyrë më ekonomike nëse është e mbushur plot.
- Me një para-trajtim të përshtatshëm, njollat dhe pislëku mund të hiqen nga teshat; më pas mund t'i lani teshat në një temperaturë më të ulët.
- Llogarisni sasinë e detergjentit sipas fortësisë së ujit, shkallës së ndotjes dhe sasisë së teshave që do të lani.

## PËRSHKRIM I PRODUKTIT



- 1 Sirtari i detergjentit
- 2 Plani i punës
- 3 Paneli i kontrollit
- 4 Doreza e hapjes së derës
- 5 Pllaka e klasifikimit (në skajin e brendshëm)
- 6 Këmbët e përparme që përshtaten



- 7 Zorra e kullimit të ujit
- 8 Mbajtësja e zorrës së shkarkimit
- 9 Mbajtëset e zorrës
- 10 Zorra e hyrjes së ujit
- 11 Kablloja e korrentit
- 12 Këmbët e pasme

## TË DHËNA TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia Lartësia Thellësia Gjerësia (përmasat e përgjithshme)	60 cm 85 cm 50 cm 55 cm
Lidhja elektrike Tensioni - Fuqja e përgjithshme - Siguresa	Të dhënat mbi lidhjen elektrike janë dhënë në pllakëzën e parametrave që ndodhet në pjesën e brendshme të derës së enëlarëses.	
Presioni i furnizimit me ujë	Minimumi Maksimum	0,05 MPa 0,8 MPa
Ngarkesa Maksimale	Të pambuktat	6 kg
Shpejtësia e Rrotullimeve	Maksimum	800 rpm (EWP86100W) 1000 rpm (EWP106100W) 1200 rpm (EWP126100W)

## INSTALIMI



## Shpaktimi

**Paralajmërim**


- Lexoni me kujdes kapitullin "Të dhëna për sigurinë" përpara se të instaloni pajisjen.

**Paralajmërim Hiqni dhe mbani të gjitha pajisjet e transportit**


- pasi mund t'i rimontoni nëse do t'ju duhet të transportoni sérish pajisjen.

**Mjetet e nevojshme** <sup>1)</sup>

- Hiqni fletën e jashtme. Nëse nevojitet, përdorni një prerëse.




- Hiqni kapakun prej kartoni.
- Hiqni materialet polistiren të ambalazhimit.
- Shtrini pjesën e përparme në dysheme pas pajisjes dhe pastaj shtrini me kujdes pajisjen me anën e pasme përmbys. Sigurohuni që gjatë këtij procesi të mos shtypet asnjë nga zorrët.




1) Këto mjete nuk ofrohen bashkë me pajisjen.


- Hiqni bazamentin prej polistireni nga pjesa e poshtme.



- Kthejeni pajisjen në pozicion vertikal.




- Hapni derën dhe hiqni udhëzuesin e zorrës plastike, qesen që mban broshurën e udhëzimit dhe tapat plastike të vidhave nga kazani.




- Hiqni kablion e ushqimit me energji dhe zorrën e kullimit dhe të hyrjes së ujit nga


- mbajtëset e zorrës ( **C** ) që ndodhen në pjesën e pasme të pajisjes.



- Zhvidhosni tre bulonat ( **A** ) dhe hiqni mbajtëset e zorrës ( **C** ).
- Rrëshqisni jashtë ndarësit plastikë përkatës ( **B** ).




- Mbyllni vrimën më të vogël të sipërme dhe dy vrimat e mëdha me tapat plastike përkatëse.




## Pozicionimi dhe nivelimi

Niveli lavatriçen duke ngritur ose ulur këmbëzat. Në varësi të modelit, pajisja mund të ketë katër këmbëza që mund të përshtaten, ose dy këmbëza të përparme që mund të përshtaten dhe dy këmbëza të pasme fikse.

Pajisja **DUHET** të jetë e niveluar dhe e qëndrueshme mbi një dysheme të qëndrueshme dhe të sheshtë. Nëse është e nevojshme, kontrolloni përzgjedhjen me një nivelues. Çdo rregullim i nevojshëm mund të bëhet me një distancator.




Niveli i duhur parandalon dridhjet, zhurmën dhe zhvendosjen e pajisjes gjatë punës. Përsëriteni veprimin e nivelimit, nëse pajisja nuk është e niveluar dhe e qëndrueshme.




## Tubi i hyrjes së ujit

- Lidhni zorrën me një rubinet me një filetim 3/4".




- Lironi rondelën për të anuar zorrën majtas apo djathtas në varësi të pozicionit të rubinetit tuaj të ujit. **Mos e vendosni zorrën e hyrjes së ujit për poshtë.**



- Mbas pozicionimit të zorrës së hyrjes, sigurohuni të shtrëngoni përsëri rondelën për të parandaluar rrjedhjet.

## Kullimi i ujit


Nëse është e nevojshme, formoni një grep në skajin e zorrës së kullimit duke përdorur udhëzuesin e zorrës plastike.



Skaji i zorrës së kullimit mund të pozicionohet në tre mënyra:




- I kapur në skajin e një lavamani duke përdorur udhëzuesin e zorrës plastike.




Lidhni udhëzuesin e zorrës plastike me rubinetin me një spango për të parandaluar shkëputjen e zorrës së kullimit kur pajisja po zbrazet.

- Në një rubinet lavamani.




Shtyjeni zorrën e kullimit në një rubinet dhe mbërthejeni atë me një kapëse, sigurohuni që të formohet një hark në zorrën e kullimit për të parandaluar hyrjen në pajisje të mbeturinave nga lavamani. Nëse rubineti dalës nuk është përdorur më parë, hiqni çdo tapë bllokuese që mund të jetë vendosur.

- Direkt në një zorrë kullimi me gjatësi jo më të vogël se 60 cm dhe jo më të madhe se 100 cm. Skaji i zorrës së kullimit duhet të **ajroset** gjithmonë, pra diametri i brendshëm i zorrës së kullimit duhet të jetë më i madh se diametri i jashtëm i zorrës së kullimit. Zorra e kullimit nuk duhet të shtypet.




- Direkt në një zorrë kullimi të futur në murin e dhomës.



- **i** Zorra e zbrazjes mund të zgjatet në një maksimum prej 4 metrash. Në Qendrën tuaj lokale mund të merrni një zorrë kullimi shtesë dhe një mekanizëm lidhës.

## Pamje e përgjithshme e lidhjeve



### Lidhja elektrike

- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që të dhënat elektrike në pllakën e specifikimeve të përkohshme të karakterizimit të rrjetit elektrik në shtëpi.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar e instaluar si duhet.
- Mos përdorni spina, lidhës dhe kablo zgjatimi të shumëfishta. Ka rrezik zjarri.
- Mos i zëvendësoni ose modifikoni vetë kabllot e ushqimit. Lidhuni me Shërbimin e passhitjes.

- Sigurohuni që spina dhe kabloja elektrike të mos shtypen ose dëmtohen nga pjesa e pasme e pajisjes.
- Sigurohuni që spina elektrike të jetë e arritshme mbas instalimit.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr spinën nga kabloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon duke e kapur nga spina.
- Kjo pajisje pajtohet me Direktivat E.E.C.



## PËRDORIMI I PARË

- i** • Sigurohuni që lidhjet elektrike dhe ato hidraulike të pajtohen me udhëzimet e instalimit.
- i** • Sigurohuni që kazani të jetë bosh.
- i** • Para larjes së parë, kryeni një cikël të pambuktash me temperaturën më të

lartë pa futur asnjë teshë në pajisje, për të hequr mbetjet e prodhimit nga kazani dhe vaska. Hidhni 1/2 mase detergjent në dhomëzën e larjes kryesore dhe ndizni pajisjen.


## PËRDORIMI I PËRDITSHËM

### Ndani teshat në grupe

Ndani simbolet e kodeve të larjes mbi etiketat e teshave si dhe udhëzimet e prodhuesit për larjen. Ndajini teshat si më poshtë: të bardha, me ngjyra, sintetike, delikate, të leshta.

### Përpara se të fusni brenda teshat

**E rëndësishme** Sigurohuni që nëpër rroba të mos mbeten objekte metalike (p.sh. karfica flokësh, paramane, pineska). Kopsitni këllëfët e jastëkëve, mbyllni zinxhirët, togëzat dhe sustat. Lidhni mirë fjongot dhe shiritat e gjatë. Hiqni të gjithë grepat (p.sh. nga perdet).



- Mos i lani asnjëherë teshat e bardha dhe ato me ngjyrë bashkë. Të bardhat mund të humbasin "bardhësinë" gjatë larjes.
- Rrobat e reja me ngjyra mund të lëshojnë ngjyrë që në larjen e parë; prandaj, herën e parë ato duhet të lahen veças.
- Fërkojeni zonat e ndotura shumë me një detergjent të veçantë ose pastë detergjenti.
- Trajtojini perdet me një kujdes të veçantë.
- Lajini çorapet dhe dorezat brenda një çante ose një rrjete.

#### **Njollat e vështira hiqini përpara se t'i lani:**

**Njolla gjaku** : trajtojini njollat e freskëta me ujë të ftohtë. Për njollat e thara, lërinijë gjithë natën në ujë me detergjent të posaçëm më pas fërkojeni me ujë dhe sapun.

**Bojëra vaji** : njomini me heqës njollash me bazë benzine, vendoseni rrobën mbi një copë të butë dhe fërkojeni njollën; trajtojini disa herë.

**Njolla yndyre të thara** : njomini me terpeninë, vendoseni teshën mbi një sipërfaqe të butë dhe fërkojeni njollën me majat e gishtave dhe me një copë pambuku.

**Ndryshk** : acid oksalik i shkrirë në ujë të nxehtë ose një produkt që heq ndryshkun i përdorur i ftohtë. Bëni kujdes me njollat e ndryshkut që nuk janë të freskëta, pasi struktura celuloze do të jetë dëmtuar tashmë dhe në copë mund të krijohet një vrimë.

**Njolla balte** : trajtojini me zbardhues, shpëlajini mirë (vetëm të bardhat dhe ato me ngjyra që nuk e humbasin ngjyrën).

**Njolla bari** : sapisinisi lehtë dhe trajtojini me zbardhues (vetëm të bardhat dhe ato me ngjyra që nuk e humbasin ngjyrën).

**Bojë stilolapsi dhe ngjitës** : njomini me aceton <sup>2)</sup>, vendoseni rrobën mbi një leckë të butë dhe fërkojeni njollën.

**Njolla buzëkuqi** : njomini me aceton si më sipër, më pas trajtojini njollat me tretës boje. Çdo shenjë të mbetur, trajtojini më pas me zbardhues.

**Verë e kuqe** : futeni në ujë me detergjent, shpëlajini dhe trajtojini me acid acetik ose citrik, e më pas shpëlajini. Çdo shenjë të mbetur, trajtojini më pas me zbardhues.


**Bojë shkrimi** : në varësi të llojit të bojës, njomini rrobën fillimisht me aceton <sup>2)</sup>, e më pas me acid acetik; trajtoni çdo njollë të mbetur në pëlhurat e bardha me zbardhues dhe pastaj shpëlajini plotësisht.

**Njolla zifti** : trajtojini fillimisht me heqës njollash, tretës boje ose benzinë, dhe më pas fërkojeni me pastë detergjente.

#### **Hapeni derën duke e tërhequr dorezën për së jashtmi**

#### **Futja e teshave në pajisje**

Vendosni rrobat në kazan, një nga një, duke i shkartisur ato sa më shumë të mundeni.



#### **Ngarkesat maksimale**

**i** Ngarkesat e këshilluara tregohen te «Tabela e programeve të larjes».

Rregulla të përgjithshme:


- **Të pambukta, të linjta** : kazani plot, por jo shumë ngjeshur;
- **Sintetike** : kazani jo më shumë se gjysmë plot;

<sup>2)</sup> mos përdorni aceton mbi mëndafsh artificial.

- **Pëlhura delikate dhe të leshtat :** kazani jo më shumë se një e treta plot.

### Mbyllni derën lehtë

- ⚠ **Paralajmërim** Sigurohuni që asnjë pëlhurë të mos ngecë kur të mbyllni derën.



### Detergjentet dhe shtesat

Rezultatet e mira të larjes varen edhe nga detergjenti i zgjedhur dhe përdorimi i sasisë së duhur, për të shmangur shpërdorimin dhe për të mbrojtur ambientin.

Edhe pse të biodegradueshme, detergjentet përmbajnë lëndë të cilat, në sasi të mëdha, mund të çrregullojnë ekuilibrin delikat të natyrës.

Zgjedhja e detergjentit varet edhe nga lloji i teshave (delikate, të leshta, të pambukta, etj.), ngjyra, temperatura e larjes si dhe shkalla e ndotjes.

Me këtë pajisje mund të përdoren të gjitha detergjentet për larje me makinë që gjenden zakonisht në treg:

- pluhurat larës për të gjitha llojet e pëlhurave,
- pluhurat larës për teshat delikate (40°C maksimumi) dhe të leshtat,
- detergjentet e lëngshme, mundësisht për programe me temperatura të ulëta (60°C maksimumi) për të gjitha llojet e teshave, ose të posaçme vetëm për të leshtat.

### Sasia e detergjentit për t'u përdorur

Lloji dhe sasia e detergjentit varen edhe nga lloji i teshave, sasia e ngarkesës, shkalla e ndotjes dhe nga fortësia e ujit.

Për sasinë e detergjentit, referojuni gjithmonë të dhënave në paketimin e produktit dhe sigurohuni që detergjenti mund të derdhet në sirtar.

Përdorni më pak detergjent, nëse:

- po lani një sasi të vogël teshash,
- teshat nuk janë shumë të ndotura,
- formohet shumë shkumë gjatë larjes.

### Shkallët e fortësisë së ujit


Fortësia e ujit klasifikohet në “shkallë” fortësie. Të dhëna mbi fortësinë e ujit në zonën tuaj mund të merrni pranë kompanisë së ujësjellësit ose nga autoritetet tuaja lokale.

Nëse shkalla e fortësisë së ujit është mesatare ose e lartë ne ju sugjerojmë të përdorni zbutës uji duke ndjekur gjithmonë udhëzimet e prodhuesit.

Kur shkalla e fortësisë është e butë, përshtatni sasinë e detergjentit.

### Hapni sirtarin e shpërndarësit të detergjentit.

☐ Dhomëza për detergjentin pluhur ose lëng të përdorur për larjen kryesore. ⚙ Dhomëza për shtesat lëng (zbutës pëlhure, ngrirës).





- ⚠ **Paralajmërim** Nëse doni që të kryeni larjen paraprake, fusni detergjent mes rrobave brenda në kazan.

- ⚠ **Paralajmërim** Në varësi të llojit të detergjentit që përdorni (pluhur ose lëng), sigurohuni që kapaku që gjendet në dhomëzën e larjes kryesore, të jetë në pozicionin e dëshiruar.

## Ndarësja për detergjentin pluhur ose të lëngshëm

### Pozicioni i ndarëses LART, nëse përdorni detergjent PLUHUR






- Hiqni sirtarin. Shtyjeni anën e sirtarit jashtë siç tregohet nga shigjetat (PUSH (SHTYJE)) për të lehtësuar heqjen e sirtarit.

### Ndarësja është poshtë dhe ju dëshironi të përdorni detergjent pluhur:



- Rrotullojeni ndarësen lart. Sigurohuni që ndarësja të përputhet plotësisht.
- Vendoseni përsëri sirtarin me kujdes në vend.

### Pozicioni i ndarëses POSHTË, nëse përdorni detergjent TË LËNGSHËM




- Matni sasinë e detergjentit.
- Hidheni detergjentin pluhur brenda dhomëzës së larjes kryesore .

### Nëse ndarësja nuk është në pozicionin e dëshiruar :




### Ndarësja është lart dhe ju dëshironi të përdorni detergjent të lëngshëm:

- Rrotullojeni ndarësen poshtë.
- Vendoseni përsëri sirtarin me kujdes në vend.



- Matni sasinë e detergjentit.


**i** Për sasinë e detergjentit, gjithmonë referojuni asaj që është shkruar në ambalazhin e produktit dhe sigurohuni që detergjenti të mund të hidhet në sirtar.


- Hidheni detergjentin e lëngshëm në ndarje  pa kaluar limitin e treguar në ndarëse. Detergjenti duhet të vendoset në dhomëzën e posaçme të sirtarit, përpara se të filloni programin e larjes.

- !** **Paralajmërim** Mos e përdorni ndarësen në pozicionin **"POSHTË"** me:
- Detergjente xhelatinozë ose detergjente me lëng të trashë.
  - Detergjent pluhur.
  - Me programe me paralarje.
  - Mos përdorni detergjent të lëngshëm nëse programi i larjes nuk fillon menjëherë.

**i** Në rastet e renditura më sipër, përdorni ndarësen në pozicionin **"LART"**.

### Matni sasinë e zbutësit.

Hidheni zbutësin ose ndonjë lëndë tjetër shtesë në dhomëzën me shenjë  (mos tejkaloni shenjë «MAX» te sirtari). Çdo lëndë shtesë duhet të vendoset në dhomëzën e posaçme të sirtarit, përpara se të filloni programin e larjes.




**Mbyllni sirtarin shpërndarës të detergjentit**

## Zgjidhni programin e larjes

Paneli i kontrollit lejon përzgjedhjen e programeve të larjes dhe opsioneve të ndryshme. Kur përzgjidhet një buton opsioni, ndizen dritat treguese përkatëse. Në rast të kundërt është e fikur.

**i** Për pajtueshmërinë midis opsioneve dhe programeve të larjes, shihni "Tabela e programeve të larjes". Nëse zgjidhet një opsion i gabuar, drita treguese e kuqe e integruar e butonit **6** pulson 3 herë.





### 1 Çelësi përzgjedhës i programit



**Rrotullojeni çelësin përzgjedhës të programit deri sa të arrini në programin e dëshiruar. Çelësi përzgjedhës mund të rrotullohet si në drejtim orar ashtu edhe kundër-orar.** Drita e gjelbër treguese e butonit **6** fillon të pulsojë: pajisja tani është e ndezur.

**i** Nëse e ktheni çelësin e zgjedhjes së programit në një program tjetër, drita treguese e kuqe e butonit **6** do të pulsojë 3 herë për të treguar një përzgjedhje të gabuar. Pajisja nuk do ta kryejë programin e ri të përzgjedhur.

- Për të **fikur pajisjen**, rrotulloni çelësin përzgjedhës të programit te pozicioni .
- Për të **anuluar** ose **ndryshuar** një program që po ekzekutohet, fikeni pajisjen duke rrotulluar çelësin përzgjedhës të programeve në pozicionin . Përzgjidhni programin e ri duke rrotulluar çelësin e përzgjedhjes së programeve në programin e dëshiruar. Startoni programin e ri duke shtypur butonin **6** sërish. Uji në kazanin e lavatriçes nuk do të zbrazet.

**2 Butoni i temperaturës**

**Shtypni butonin e temperaturës për të përzgjedhur temperaturën më të përshtatshme për larjen e rrobave tuaja.**

✱ : Larje me ujë të ftohtë.

**3 Shtrydhje e reduktuar dhe Shpëlarje me pushim**

Duke zgjedhur një program, pajisja juaj automatikisht propozon shpejtësinë maksimale të rrotullimit për atë program.

Shtypeni këtë buton disa herë për të ndryshuar shpejtësinë e rrotullimeve, nëse dëshironi që rrobat tuaja të shtrydhen me shpejtësi të ndryshme. Ndizet drita përkatëse.

**□ Shpëlarje me pushim**

Duke zgjedhur këtë opsion, të gjitha fazat e rrotullimit nuk kryhen dhe zëvendësohen nga kullimi i ujit, për të mos zhubrosur teshat. Rekomandohet për rrobat tepër delikate. Në disa programe shpëlarjet do të bëhen me më shumë ujë.

**4 Super i shpejtë**

Duke shtypur këtë buton ndizet drita përkatëse.

Cikël i shkurtër për rrobat me ndotje të lehtë ose që kanë nevojë vetëm për rifreskim.

Me këtë opsion, rekomandohet një ngarkesë e reduktuar rrobash:

- Të pambukta 3 Kg
- Sintetike dhe delikate 1,5 Kg


**Shpëlarje shtesë**

Kjo pajisje është projektuar në mënyrë të tillë, që të kursejë ujë. Megjithatë, për njerëzit me lëkurë shumë delikate (alergjikët ndaj detergjenteve) mund të jetë e nevojshme t'i shpëllajnë teshat me një sasi më të madhe uji.

Shtypni njëkohësisht butonat **3** dhe **4** për disa sekonda: drita treguese **7.2** ndizet. Ky funksion rri gjithmonë aktiv. Për ta çaktivizuar atë shtypni të njëjtët butona sërish, derisa drita treguese **7.2** fiket.



## 5 Shtyrja e programit



Fillimi i programit mund të vonohet me 9, 6 ose 3 orë me anë të këtij butoni. Ndizet drita përkatëse. Ju duhet të zgjidhni këtë opsion pasi të keni vendosur programin dhe përpara se të nisni programin.

### **Përzgjidhni një shtyrje të fillimit të programit:**

- zgjidhni programin dhe opsionet e kërkuara;
- përzgjidhni shtyrjen e fillimit duke shtypur butonin **5** ;
- shtypni butonin **6** :
  - pajisja fillon numërimin mbrapsht të orëve.
  - Programi do të fillojë pasi të ketë përfunduar shtyrja e programit.

### **Anulimi i shtyrjes së fillimit mbasi e keni filluar programin:**

- vendoseni pajisjen në PAUZË duke shtypur butonin **6** ;
  - shtypni butonin **5** një herë, drita përkatëse e vonimit të zgjedhur fiket;
  - shtypni sërish butonin **6** për të filluar programin.
- SHTYRJA E PROGRAMIT **NUK MUND** të zgjidhet me programin e kullimit.

**E rëndësishme** Shtyrja e përzgjedhur mund të ndryshohet vetëm mbasi ta përzgjidhni programin e larges përsëri. Dera do të bllokohet gjatë gjithë kohës së shtyrjes. Nëse doni të hapni derën, duhet ta vendosni pajisjen në PAUZË (duke shtypur butonin **6** ) dhe prisni disa minuta. Mbasi keni mbyllur derën, shtypni butonin **6** përsëri.

## 6 Nis/Ndërprit



### Dritat treguese

7.1



7.2




7.3




### Në fund të programit


Pajisja ndalon automatikisht. Drita treguese e butonit **6** dhe drita treguese pilote që i përket fazës së sapa përfunduar, fikën. Drita **7.3** ndriçon.

Nëse keni zgjedhur një program apo një opsion që përfundon me ujë të mbetur në kazan dhe dera mbetet e bllokuar për të treguar se fillimisht duhet të zbrazet uji përpara se të hapni derën.

- Ndiqni udhëzimet e mëposhtme për të zbrazur ujin:
- Rrotullojeni çelësin e funksionit në .
- Përzgjidhni programin për tharje ose centrifugim.


### Nisni programin duke shtypur butonin 6

- Për të **nisur** programin e zgjedhur, shtypni butonin **6**, drita treguese jeshile përkatëse ndalon së pulsuar. Drita treguese **7.1** shfaqet në ekran për të treguar që pajisja fillon funksionimin dhe dera bllokohet. Nëse keni zgjedhur shtyrjen e fillimit të programit, pajisja do të fillojë numërimin mbrapsht.
- Për të **ndërprerë** një program që është duke u kryer, shtypni butonin **6**: drita jeshile përkatëse fillon të pulsojë. Është e mundur që **të ndryshohen** disa opsione të një programi në ekzekutim para se programi t'i kryejë ato.
- Për të **rifilluar** programin nga momenti kur u ndërpre, shtypni butonin **6**.
- Pasi programi ka filluar, dera bllokohet. Nëse, për ndonjë arsye, doni të **hapni derën**, vendoseni si fillim pajisjen në PAUZË duke shtypur butonin **6**. Pas pak minutash do të jetë e mundur hapja e derës. Nëse dera mbetet e mbyllur, kjo do të thotë se pajisja është duke ngrohur ujin ose se niveli i ujit është shumë i lartë. Për çdo rast, mos provoni ta hapni derën me forcë!  
Nëse nuk mund ta hapni derën por duhet ta bëni këtë, duhet të fikni pajisjen duke rrotulluar çelësin përzgjedhës në . Pas pak minutash, dera mund të hapet (**bëni kujdes nivelin dhe temperaturën e ujit!**). Pasi të mbyllni derën, është e nevojshme të përzgjidhni sërish programin dhe përzgjedhjet e tij si dhe të shtypni butonin **6**.
- Kur nisni programin duke shtypur butonin **6**, drita treguese e larjes (**7.1**) ndriçon. Kjo do të thotë se pajisja është duke punuar.
- Drita treguese e shpërlarjes shtesë (**7.2**) ndriçon kur pajisja kryen shpërlarje shtesë.
- Kur programi të përfundojë ndizet drita treguese e mbarimit të ciklit (**7.3**).

- Zvogëloni shpejtësinë e centrifugimit nëse është nevoja, duke shtypur butonin përkatës.
- Shtypni butonin **6**.  
Në përfundim të programit, dera tani mund të hapet. Rrotulloni çelësin përzgjedhës të programit tek pozicioni  për të fikur pajisjen.  
Nxirrni rrobat nga kazan i lavatrites dhe kontrolloni që kazanin të jetë bosh. Nëse nuk keni ndërmend të kryeni një larje tjetër, mbyllni rubinetin e ujit. Lini derën hapur për të shmangur formimin e mykut dhe të erërave të pakëndshme.

**!** **Paralajmërim** Nëse në shtëpi keni fëmijë të vegjël ose kafshë shtëpiake, **aktivizoni mekanizmin e sigurisë së fëmijëve** në anën e brendshme të kornizës së derës (për më shumë hollësira lexoni "Siguria e fëmijëve" në kapitullin "Të dhëna për sigurinë").










**i** **Peçullimi** : gjatë parametrizimit të programit dhe menjëherë pas mbarimit të programit, nëse nuk është prekur çelësi përzgjedhës i programit dhe çdo buton tjetër, pas pak minutash aktivizohet sistemi i kursimit të sigurisë. Dritat treguese fikën. Drita e gjelbër treguese e butonit **6** pulson me frekuencë të ulët. Duke shtypur cilindro buton, pajisja do të dalë nga gjendja e kursimit të energjisë.















### Guarnicioni i derës



Në fund të ciklit, kontrollojeni herë pas here guarnicionin e derës dhe objekte që mund të ngecin në pjesën e palosur.

## PROGRAMET E LARJES

Programi – Temperatura maksimale dhe minimale – Përshkrimi i ciklit – Shpejtësia maksimale e centrifugimit – Ngarkesa maksimale e rrobave – Lloji i rrobave	Opsionet	Dhomëza e detergjentit
<p> <b>TË PAMBUKTAT</b>            95° -  (Ujë i ftohtë)            Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm për EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm për EWP126100W            Ngarkesa maks. 6 kg - Ngarkesa e reduktuar 3 kg  <b>Për të pambukta të bardha dhe me ngjyra dhe të linjta</b> . Rroba me ndotje normale.</p>	PAKËSIM I SHTRYDHJEVE, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHUMË E SHPEJTË <sup>1)</sup> , SHPËLARJE SHITESË, SHTYRJA E PROGRAMIT	 
<p> +  <b>TË PAMBUKTA ME PARALARJE</b>            95° -  (Ujë i ftohtë)            Larje paraprake - Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm për EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm për EWP126100W            Ngarkesa maks. 6 kg - Ngarkesa e reduktuar 3 kg  <b>Për të pambukta të bardha dhe me ngjyra dhe të linjta</b> . Rroba shumë të ndotura.</p>	PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHUMË E SHPEJTË <sup>1)</sup> , SHPËLARJE SHITESË, FILLIM I VONUAR	 

Programi – Temperatura maksimale dhe minimale – Përshkrimi i ciklit – Shpejtësia maksimale e centrifugimit - Ngarkesa maksimale e rrobave – Lloji i rrobave	Opsionet	Dhomëza e detergentit
 <b>TË PAMBUKTA EKONOMIKE</b> 60° - 40° Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm për EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm për EWP126100W Ngarkesa maks. 6 kg <b>Të pambukta të bardha dhe me ngjyrë</b> . Ky program mund të përzgjidhet për rroba të pambukta me ndotje të lehtë ose normale. Temperatura do të ulet dhe koha e larjes do të zgjatet. Kjo ju mundëson një larje të mirë duke kursyer energji.	PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHPËLARJE SHITESË, FILLIM I VONUAR	 
 <b>SINETIKE</b> 60° -  (Ujë i ftohtë) Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm EWP126100W Ngarkesa maks. 3 kg - Ngarkesa e reduktuar 1,5 kg <b>Materiale sintetike ose të përziera</b> : të brendshme, rroba me ngjyra, këmisha që nuk zgjerohen, bluza. Rroba me ndotje normale.	PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHUMË E SHPEJTË <sup>1)</sup> , SHPËLARJE SHITESË, FILLIM I VONUAR	 
 <b>PËLHURA TË PËRZIERA</b> Ujë i ftohtë Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm EWP126100W Ngarkesa maks. 3 kg Program për larje me ujë të ftohtë me kursim të lartë energjie për rroba të ndotura pak. Ky program kërkon detergjente që janë aktive në ujë të ftohtë.	PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHPËLARJE SHITESË, FILLIM I VONUAR	 
 <b>DELIKATE</b> 40° -  (Ujë i ftohtë) Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 700 rpm Ngarkesa maks. kg 3 - Ngarkesa e reduktuar 1,5 kg <sup>1)</sup> <b>Pëlhuara delikate</b> : akrilike, viskoze, poliestër. Rroba me ndotje normale.	NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHUMË E SHPEJTË <sup>1)</sup> , SHPËLARJE SHITESË, FILLIM I VONUAR	 
  <b>TË LESHTAT / LARJA ME DORË</b>   40° -  (Ujë i ftohtë) Larje kryesore - Shpëlarje - Shpejtësia maksimale e centrifugimit: 800 rpm për EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm për EWP126100W Ngarkesa maks. 2 kg <b>Të leshtat e përshtatshme për larje në lavatriçe, dhe rroba të leshta dhe delikate që lahen me dorë dhe që kanë simbolin "larje me dorë".</b> . Shënim : Një rrobë e vetme ose e rëndë mund të shkaktojë çekuilibrim. Nëse pajisja e nuk kryen centrifugimin përfundimtar, shtoni më shumë rroba, rishpërndajeni ngarkesën me dorë dhe pastaj përzgjidhni programin e centrifugimit.	PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, FILLIM I VONUAR	 

Programi – Temperatura maksimale dhe minimale – Përshkrimi i ciklit – Shpejtësia maksimale e centrifugimit - Ngarkesa maksimale e rrobave – Lloji i rrobave	Opsionet	Dhomëza e detergjentit
<p> <b>SHPËLARJE</b> Shpëlarje - Centrifugim i shkurtër 700 rpm. Nëse përzgjidhet një shpejtësi shtrydhjeje më e madhe se 700 rpm, duke shtypur butonin përkatëse, pajisja kryen një shtrydhje më të gjatë. (Shpejtësia maksimale e rrotullimit: 800 rpm për EWP86100W, 1000 rpm për EWP106100W, 1200 rpm për EWP126100W) Ngarkesa maks. 6 kg Për të shpëlarë dhe shtrydhur rrobat prej pambuku të cilat janë larë me dorë. Për të shtuar veprimin e shpëlarjes, zgjidhni opsionin SHPËLARJE SHITESË. Pajisja do të shtojë shpëlarje shitesë.</p>	<p>PAKËSIM TË CENTRIFUGIMIT, NDËRPREJE E SHPËLARJES, SHPËLARJE SHITESË, SHTRYRJA E PROGRAMIT</p>	
<p> <b>THARJA</b> Kullimi i ujit Për të zbrazur ujin e mbetur në kazan.</p>		
